



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1458/3 Prot.

Tirane, më 31.05 2024

VENDIM

Nr. 27 dt. 31.05 2024

“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN
E SPORTEVE TË TIRANËS.

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, të nenit 3; pika 3 dhe 4, të nenit 44, të nenit 49, të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës të nenit 30, të nenit 43, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 35 datë 21.10.2019 “Mbi Miratimin e Rregullorës Financiare dhe e Shpërndarjes së të Ardhurave të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në shkresën e Këshillit të Etikës nr.1381 datë 17.05.2024 “Trajtim Financiar i Anëtarëve të Këshillit të Etikës”, në Vendimin e Rektoratit me nr.38 datë 20.05.2024, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.39 datë 28.05.2024, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 31.05.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e anëtarëve të Këshillit të Etikës në vlerën prej 5.000 (pesëmijë) lekë për mbledhje, për cdo anëtar.
2. Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Etikës të mbulohet nga të ardhurat dytësore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
4. Ngarkohet për publikim në faqen www.ust.edu.al dhe tek Transparenca Universitare, Drejtorja e Zhvillimit të Programve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR COBANI

